

Nr. 0596/17

Data 13.03.2017
PRISHTINE



RADIOTELEVISIONI I KOSOVËS
RADIO TELEVIIZIJA KOSOVA
RADIO TELEVISION OF KOSOVO

RREGULLORE

PËR

AVANCIMIN E TË PUNËSUARVE NË

RADIOTELEVISIONIN E KOSOVËS

Në bazë të Ligjit të RTK-së, neni 29, pika 2.2 dhe të Statutit të RTK-së, neni 36, pika 7, Bordi i RTK-së miraton këtë:

RREGULLORE PËR AVANCIMIN E TË PUNËSUARVE NË RADIOTELEVISIONIN E KOSOVËS

Neni 1 QËLLIMI

Me këtë rregullore përcaktohet mënyra e avancimit të të punësuarve në RTK, baza dhe kushtet për avancimin e të punësuarve.

Neni 2 FUSHËVEPRIMI

Kjo rregullore vlen për të gjithë të punësuarit, të cilët janë punëtorë të rregullt në RTK.

Neni 3 PËRKUFIZIMET

1. Shprehja e përdorur në këtë Rregullore ka këtë kuptim:

1.1. Avancim horizontal: nënkupton ngritjen e punëtorit në detyrë dhe përgjegjësi shtesë në kuadër të RTK-së.

Neni 4 MËNYRA E AVANCIMIT

1. Avancimi bëhet në bazë të propozimit me shkrim, të cilin e bën mbikëqyrësi i drejtpërdrejtë i të punësuarit.
2. Propozimi mund të paraqitet vetëm një herë brenda një viti kalendarik, pas përfundimit të procesit të vlerësimit të performancës nga ana e drejtorëve të njësive programore dhe udhëheqësve të sektorit. Përmbajtja e propozimit me shkrim për avancim është e përshkruar me formularin për avancim, i cili është pjesë përbërëse e kësaj Rregulloreje (Shtojca 1).

Neni 5 KËRKESA PËR AVANCIM

1. Për kërkesën për avancim vendos eprori i cili është përgjegjës për avancim. Drejtori i Radios dhe Televizionit, Udhëheqësi i shërbimeve të përbashkëta së pari verifikojnë nëse propozimi është shtruar nga personi përkatës brenda afatit të kërkuar.

2. Propozimi refuzohet nëse nuk është bërë nga personi përkatës dhe është me përmbajtje joadekuate ose nëse nuk është bërë në afatin e paraparë.

Neni 6
PROPOZIMET PËR AVANCIM

1. Drejtorët e Radios dhe të Televizionit, si dhe Udhëheqësi i shërbimeve të përbashkëta janë të obliguar që për të gjitha propozimet të marrin edhe mendimin e Shërbimit të administratës dhe burimeve njerëzore, i cili vlerëson të gjitha propozimet, në bazë të formularit për avancim.
2. Drejtorët e Radios dhe të Televizionit, si dhe Udhëheqësi i shërbimeve të përbashkëta, propozimet që janë vlefshme, bashkë me mendimin mbi arsyeshmërinë e shërbimit të administratës dhe burimeve njerëzore, ia propozojnë për vendim Drejtorit të Përgjithshëm të RTK-së.

Neni 7
VENDIMI PËR AVANCIM

1. Drejtori i Përgjithshëm i RTK-së, në bazë të propozimeve që ka marrë, të plotësuara me mendimet përkatëse, vendos për arsyeshmërinë e avancimit të të punësuarve të propozuar.
2. Drejtori i Përgjithshëm i RTK-së merr vendim, me të cilin e miraton propozimin dhe lëshon vendimin për avancimin e të punësuarit, ose e refuzon propozimin.
3. Me rastin e lëshimit të vendimit për avancim, Drejtori i Përgjithshëm i RTK-së respekton arsyeshmërinë e iniciativës.

Neni 8
PËRCAKTIMI KOHOR I AVANCIMIT HORIZONTAL

Punëtori mund të avancohet për herë të parë pas 3 vjetësh të kaluara në të njëjtin vend të punës, kurse në raste të veçanta, sipas procedurës së përshkruar, edhe më herët.

Neni 9
PËRCAKTIMI MATERIAL I AVANCIMIT HORIZONTAL

1. I punësuarit avancohet, sipas rregullit, në përputhje me koeficientin përkatës.
2. Koeficientin e verifikon dhe e miraton Drejtori i Përgjithshëm i RTK-së, në bazë të propozimit apo iniciativës së Drejtorit të Radios dhe Televizionit apo Udhëheqësit të Shërbimeve të përbashkëta.

Neni 10
KUSHTET E AVANCIMIT HORIZONTAL

Kushtet për avancim janë: vetiniciativa e punëtorit dhe qëndrimi i tij ndaj punës dhe ambientit të punës, vlerësimi vjetor i performancës së punës dhe aftësitë për krijim dhe dizajnim të përmbajtjeve programore.

Neni 11
KUSHTET PËRJASHTUESE

Punëtori nuk mund të avancohet në pagë, nëse në vitin e fundit ka qenë i sanksionuar me masë disiplinore. Përrjashtim ka në rastet kur vendimi disiplinor është rrëzuar nga një instancë tjetër më e lartë.

Neni 12
KOHËZGJATJA E AVANCIMIT

1. Vendimi për avancimin e punëtorit bëhet me kontratën e punësimit, me të cilën është përcaktuar lartësia e shtesave në pagën bazë.
2. Kontrata hyn në fuqi në bazë të vendimit paraprak për avancimin e të punësuarit.

Neni 13
AVANCIMI VERTIKAL

1. Propozimin për ndërrim të vendit të punës e bën mbikëqyrësi, në rast të ndryshimeve në planin vjetor ose risistematizimin e vendeve të punës.
2. Avancimi vertikal bëhet me procedurat e njëjta sikur të avancimi horizontal.

Neni 14
ZBATIMI DHE MBIKËQYRJA E RREGULLORES

1. Për hartimin e raportit për avancim është i obliguar shërbimi i administratës dhe burimeve njerëzore. Analizat duhet të përfshijnë numrin e propozimeve dhe vendimeve të miratuara.
2. Për vendimet për avancime, Bordi i Drejtorëve njoftohet nga Drejtori i Përgjithshëm.

Neni 15
HYRJA NË FUQI

Kjo Rregullore hyn në fuqi 8 ditë pas nënshkrimit të saj.

Kryetari i Bordit të RTK-së

Ismet Bexheti

